


raporti vjetor 2001



Shërbimi i transmetimit publik të Kosovës

Bordi i Drejtorëve i RTK-së

Kryetar

Z. Adem Demaçi

Nënkryetarë

Znj. Vjosa Dobruna

Z. Blerim Reka

Anëtarë

Znj. Ismije Beshiri

Znj. Sofia Carrondo

Z. Milazim Krasniqi

Z. Jean-Bernard Münch

Znj. Sadija Niksic

Z. Nuhi Rexhepi





Çka është RTK-ja

RTK-ja është shërbim publik transmetues.

Televizioni i RTK-së transmeton pesëmbëdhjetë orë program në ditë, në rrjetin terrestrial në Kosovë dhe në atë digjital satelitor në tërë Europën.

RTK-ja ka dy shërbime të radios, Radio Kosova dhe Radio Blue Sky, që të dyja transmetojnë nga 24 orë në ditë.

RTK-ja është e pavarur sa i përket editorialitetit. Nuk ka mendime të saj editoriale dhe është e drejtë dhe e paanshme. Angazhohet në dhënien e lajmeve dhe informatave të cilat janë korrekte, të ekuilibruara dhe të sakta dhe që të jetë në shërbim të të gjitha komuniteteve të Kosovës.


RTK-ja transmeton program në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake dhe turke.

RTK-ja funksionon në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2001/13 si një organizatë publike vetëmenaxhuese, e udhëhequr nga Drejtori i Përgjithshëm i cili i përgjigjet Bordit të Drejtorëve që është apolitik.

Tabela e përmbajtjes

Parathënia nga Kryesuesi i Bordit	6
Hyrje nga Drejtori i Përgjithshëm	7
Themelimi i RTK-së si shërbim publik i transmetimit	8
RTK-ja - e pavarur dhe e paanshme	9
Shqyrtimi i vitit - Televizioni	11
Politika programore, shikueshmëria,	11
Lajmet,	17
Dhënia e mundësisë së shprehjes të gjitha komuniteteve,	19
Programi për fëmijë dhe të rinj, arti dhe kultura,	21
Programi informativ, Diskutimi dhe Debati,	24
Muzika dhe Argëtimi,	25
Sporti, Ngjarjet e veçanta	26
Shqyrtimi i vitit - Radio	27
Zhvillimi programor, lajmet dhe informimi,	29
Dhënia e mundësisë së shprehjes të gjitha komuniteteve, Sporti	30
Programet e bazuara në fakte, Muzika,	32
Shou me biseda (Talk Show), Ngjarjet e veçanta	33
Financimi i RTK-së	34
Shqyrtimi financiar	35
Resurset njerëzore	38
Përgjegjësia	40
Të shikuarit përpara në vitin 2002	41





Parathënie

Për shkak se ishim të zënë me shumë punë dhe detyra që duheshin kryer brenda një kohe shumë të shkurtër, pas një vonesë të konsiderueshme. Bordi i Drejtorëve i RTK-së, në bashkëpunim të ngushtë me stafin menagjues të këtij institucioni fort të rëndësishëm të Kosovës, po del me një publikim të shkurtër, që përshkruan aktivitetin e vitit të kaluar të RTK-së dhe që bën fjalë edhe për synimet tona zhvillimore në vitin vijues 2002 e më tutje.

Ky publikim ka për qëllim që të prezantojë para opinionit të interesuar dhe para qytetarëve tanë të nderuar punën tonë me përgjegjësi dhe me vështirësi të mëdha.

Këtë transparencë ne do ta praktikojmë edhe në të ardhmen.

Për RTK-në, paraqitet edhe ndonjë dezinformim, nga mosnjohja e fakteve dhe ndonjëherë ka edhe ndonjë shkrim joobjektiv dhe joqëllimor ndaj RTK-së. Ne nuk kemi ndërmend që të lëshohemi në polemikë me askë; përgjigja jonë është dhe do të jetë produksioni ynë gjithnjë e më cilësor dhe gjithnjë më i gjerë në interes të qytetarëve tanë në Kosovë e në botë.

Vërejtjet dhe sugjerimet e qytetarëve tanë për punën dhe zhvillimin tonë ishin dhe do të jenë kurdoherë të mirëseardhura.

Adem Demaçi,
kryetar i Bordit të Drejtorëve të RTK-së

Fjala e drejtorit të përgjithshëm

Ky ishte një vit i rritjes, zhvillimit dhe ekspansionit programor për RTK-në. Kur keni shikuar televizionin apo kur keni dëgjuar radion, keni parë se RTK-ja gjatë vitit 2001 ju ka ofruar juve, shikuesve dhe dëgjuesve të vet, një shtrirje të gjerë të programeve informative, edukative dhe argëtuese. Produksioni vendor është shtuar dhe të gjitha ngjarjet me rëndësi për ju janë transmetuar drejtpërdrejt. Shërbimi i ynë ndaj Kosovës është që të sigurohemi se qytetarët tanë janë të informuar në mënyrë të paanshme dhe objektive për të gjithë çështjet që ndikojnë tek ta në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të thërthortë. Argëtimi i të gjithë shikuesve dhe dëgjuesve tanë është një pjesë e rëndësishme e shërbimit publik të transmetimit gjë e cila është bërë nëpërmjet vënjes në skemën programore të programeve të popullarizuara dhe më profesionale.

RTK ka shënuar kthesë gjatë vitit 2001. Televizioni i ynë, i cili mund të ndiqet në rrjetin terestrial dhe atë satelitor digjital, ka filluar me programme të reja si dhe ka përmirësuar ato ekzistuese. Dy radiostacionet tona, Radio Kosova dhe Radio Blue Sky, vazhdojnë të zgjerojnë audiencën me lajme, muzikë, kontakt-program dhe sport.

Ne shpresojmë se ju ndani të njëjtin qëllim me ne, bërjen dhe konsolidimin e RTK-së si model të transmetimit publik në Europën Juglindore. Programi ynë multietnik është një element i fuqishëm i asaj që e bën RTK-në një projekt të suksesshëm. RTK-ja është transmetues për Kosovën. Ne transmetojmë në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe boshnjake, sepse besojmë në një Kosovë ku duhet të kultivohet llojllojshmëria etnike dhe religjioze. E kaluara nuk mundet dhe nuk duhet të harrohet, por ajo duhet gradualisht t'ia lëshojë rrugën të së ardhmes përplot shpresa për një përparim të përbashkët. RTK-ja është pjesë e këtij procesi.

Z. Agim Zatriqi
Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së





Themelimi i RTK-së si shërbim publik transmetues

Në gusht të vitit 1999, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Europian (OSBE) ftoi Unionin Europian të Transmetimit (EBU) që të ngrisë dhe të drejtojë një shërbim televiziv emergjent në Kosovë. Në muajin vijues, RTK-ja filloi me dy orë program në ditë. Në tetor të vitit 1999, Radio Kosova, e cila kishte filluar punën tre muaj më parë si Radio Prishtina, u bë pjesë e RTK-së. Në gusht të vitit 2000, radiostacioni i UNMIK-ut, Radio Blue Sky, u transferua tek RTK-ja.

RTK-ja u menagjua nga ana e EBU-së deri në fund të vitit 2001, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit me OSBE-në. RTK-ja pati mundësinë që të përfitojë nga përkrahja dhe shërbimet profesionale të asociacionit më të madh profesional botëror të transmetuesve publik kombëtarë. Në fazën sfiduese fillestare, qasja në shërbimet si këmbimi i lajmeve në Eurovision ka qenë e një vlere të madhe për themelimin e RTK-së si një transmetues profesional.

Në qershor të vitit 2001, u bë njohja formale e RTK-së si - shërbim publik transmetues i Kosovës me anë të Rregullores së UNMIK-ut 2001/13. Rregullorja vendosi parimet udhëzuese të shërbimit publik transmetues dhe themeloi Bordin apolitik të Drejtorëve i cili mban përgjegjësinë për politikën e RTK-së. Bordi u konstitutua më 25 shtator të vitit 2001.

Në fund të vitit 2001, EBU-ja hoqi dorë nga përgjegjësia mbi RTK-në dhe z. Agim Zatriqi, nga Bordi i Drejtorëve të RTK-së, u emërua Drejtor i parë vendor i Përgjithshëm, duke zëvendësuar z. Richard Lucas.

RTK-ja - e pavarur dhe e paanshme


Si shërbim i transmetimeve publike, RTK-ja është e liruar nga ndikimi qeveritar apo politik. Pavarësia e saj redaktuese dhe gazetaria e matur dhe e pavarur janë karakteristikat më të rëndësishme përkufizuese të RTK-së.

Ky parim është konfirmuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/13 ku kërkohet që RTK-ja 'të jetë e pavarur dhe e paanshme, duke pasqyruar integritetin dhe objektivitetin redaktues'. Përveç kësaj, Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme thotë që institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes do të jenë përgjegjëse për 'garantimin e pavarësisë redaktuese të transmetuesit publik, duke ruajtur pavarësinë e Bordit'.

Qëllimi i RTK-së është që t'i shërbejë opinionit dhe opinioni duhet të ketë mundësinë që të besojë në integritetin e transmetuesit publik. Shikuesit duhet të jenë të bindur se vendimet janë marrë vetëm për arsye të mbështetura redaktuese dhe profesionale dhe jo si rezultat i ndërhyrjes politike apo i presionit të papëlqyeshëm.

RTK-ja ka arritur reputacion për korrektësinë, paanshmërinë dhe pavarësinë e saj redaktuese dhe syqeltësia konstante nga ana e Menagjimentit, Redaktorëve dhe gazetarëve do të siguronte që kjo arritje e fituar me shumë mund të mos zbehet në asnjë mënyrë.





Shqyrtimi i vitit

2001-shi ka qenë një vit i rritjes dhe i zhvillimit të RTK-së. Kohëzgjatja e programit televiziv u zgjerua nga katër orë, sa ishte në fillim të vitit në dymbëdhjetë orë në fund të vitit. Janë prezentuar programe të reja, Gazetaria e lajmeve dhe ajo javore janë fuqizuar, si dhe është zgjeruar programi për minoritetet. Më shumë ngjarje janë mbuluar drejtpërdrejt, përfshirë të gjitha seancat e Këshillit Tranzitor të Kosovës dhe të Kuvendit të ri. Mbulimi i drejtpërdrejtë i ngjarjeve sportive është zgjeruar, përfshirë këtu basketbollin kosovar dhe futbollin evropian. Është emëruar drejtori i ri i televizionit, i cili i ka dhënë një shtytje shtesë këtyre zhvillimeve.

Në radio, përqëndrimi ka qenë në konsolidimin dhe në përmirësimin e prodhimit të programore në Radio Kosovë dhe Radio Blue Sky, dhe në afrimin e operacioneve dhe shërbimeve përkrahëse të të dy radiove për të shmangur dyfishimin e panevojshëm. Lajmet janë përforcuar nëpërmes planifikimit të përbashkët dhe këmbimit të lajmeve të mbledhura. Të dy stacionet filuan dhënjën e drejtpërdrejtë të programit në faqet e tyre në internet për të arritur një dëgjueshmëri të shtrirë në tërë botën.

Televizioni dhe radio raportuan për zgjedhjet e vjeshtës në mënyrë të plotë dhe profesionale duke i dhënë vëmendje të posaçme qasjes korrekte dhe të barabartë për të gjitha partitë, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike apo ideologjinë partiake. Kjo edhe është konfirmuar nga ana e raporteve të OSBE-së mbi Monitorimin e Mediave.

Si rezultat i kontrollit të kujdesshëm të shpenzimeve, RTK-ja ka shpenzuar më pak se që është parashikuar në planin e saj të biznesit. Përkundër zhvillimeve të saja programore, shpenzimi i planifikuar për televizionin është ulur për 24%. Shpenzimet e përgjithshme të RTK-së janë mbuluar nga donatorët dhe nga të hyrat plotësuese komerciale dhe RTK-ja ka përmbyllur vitin me një bilanc të vogël pozitiv.

RTK-ja me sukses ka implementuar programin e saj të transferimit të përgjegjësive dhe të ekspertizës nga ekipi menagjues ndërkombëtar tek ai vendor. Mund të argumentohet se RTK-ja ka qenë institucioni i parë publik që ka përfunduar transferimin e përgjegjësive.

Shqyrtimi i vitit - Televizioni

Politika programore

RTK-ja është e obliguar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2001/13 që të vendos ekuilibër mes programeve me interes të përgjithshëm dhe programeve të veçanta që i shërbejnë nevojave të shikuesve-dëgjuesve të ndryshëm.



Këtë e arrin përmes kombinimit të programit të lajmeve, sportit, programeve të bazuara në fakte, programeve mbi çështjet aktuale, dokumentareve, debateve dhe diskutimeve, kulturës, programeve për fëmijë dhe të rinjë, muzikës, argëtimit, filmave, serive dhe humorit. Qëllimi i RTK-së është që të informojë, sqarojë dhe argëtojë.

RTK-ja është një transmetues serioz që inkurajon lirinë e shprehjes dhe mundësinë që të dëgjohen të gjitha mendimet. RTK-ja nuk frikësohet që të trajtojë tema të vështira apo tabu-tema.

Porse, poashtu beson se shërbimi publik transmetues duhet të ofrojë programe të kërkuara të argëtimit dhe të relaksimit qofshin ato ngjarje sportive, muzikore, humoristike apo seriale. Këto programe i sjellin njerëzit së bashku nëpërmes përvojës së këmbyer dhe janë pjesë e kombinimit të gjerë programor të cilin e pret publiku nga një shërbim të cilin do ta financojë drejtpërdrejt kur të fillohet me parapagimin për transmetuesin publik.

65% të programit të RTK-së është prodhimtari vendore dhe 35% sigurohet nga transmetuesit apo shtëpitë e huaja të produksionit.





Përqindja e zhanreve programore: Televizioni Burimi: RTK

Programi që është siguruar gjatë vitit 2001 ka begatuar programin e RTK-së në fushën e dokumentareve, programeve për fëmijë, kulturës, filmave dhe serialeve. Asocijimi i RTK-së me EBU-në i ka mundësuar që të sigurojë shumicën e programeve pa pagesë, por mundësia për program pa pagesë tani është shumë më e kufizuar dhe çmimi për blerjen e programeve do të rritet. Gjatë vitit 2001 shikuesit kosovarë kanë parë programe nga Canal France International, Arte, ORF (Austri), Channel 4 (Britani e Madhe), TVE (Spanjë), RTB (Belgjikë), Deutsche Welle, RTE (Irland), dhe CINAR (Kanada). EBU ka mundësuar sigurimin e programeve të animuara dhe atyre arsimore për fëmijë të kualitetit të lartë të prodhuara në bashkëpunim me partnerët e saj.


Rrjeti i Transmetimit Terestrial të Kosovës

Shërbimet e radios dhe të televizionit të RTK-së në Kosovë transmetohen nëpërmes Rrjetit të Transmetimit Terestrial në Kosovë (KTTN), i cili arrin përafërsisht tek 80% e popullatës. Janë pesë vendndodhje të transmetuesve; kodra e Prishtinës, Goleshi, Zatriqi (afër Rahovecit), Zelani (afër Gjilanit) dhe Cërnusha (afër Mitrovicës). RTK-ja çmon lartë financimin nga USAID-i dhe pajisjet e siguruar nga Qeveria e Japonisë, ku me këto u mundësua ndërtimi i KTTN-së për përdorim nga të gjithë transmetuesit që transmetojnë në tërë Kosovën.

Shikueshmëria

RTK-ja është stacioni më i shikuar televiziv në Kosovë. Në vjeshtën e kaluar është bërë një anketë e madhe e hulumtimit të shikueshmërisë së të gjitha televizioneve dhe radiove nga ana e IREX-it. Anketa është bërë gjatë një periudhe dyjavore në fund të shtatorit dhe në fillim të tetorit.

RTK-ja shikohet çdo javë nga ana e 67% të popullatës nga të gjitha komunitetet. Çdo ditë 57% e popullatës shikon RTK-në, më shumë se cilindo stacion tjetër kosovar apo ndërkombëtar. Në një territor me përqindje të lartë të të rinjve është e rëndësishme që emetuesi publik të tërheqë shikuesit në moshë më të re e poashtu edhe ata në moshë më të pjekur. 69% e grupmoshës 20-29 vjeç dhe 66% të asaj 12-19 vjeç shikon RTK-në çdo javë. Më shumë se 60% e çdo grupmoshe zgjedh të shikoj RTK-në çdo javë, nga tinxherët e deri tek ata të moshës mbi 60 vjet. 51% e shikuesve të RTK-së janë femra dhe 49% meshkuj. Programi më i shikuar televiziv në Kosovë janë lajmet kryesore të mbrëmjes të orës 19.30 në RTK të cilat kanë 68% të shikueshmërisë së televizionit në ora 19.30.



Ndarja në % e shikueshmërisë: Dymbëdhjetë programet kryesore, 28/ 09 - 11/ 10

Burimi: IREX






Lajmet

Lajmet kryesore të mbrëmjes në RTK janë burimi më i rëndësishëm i informimit për opinionin. Kjo sjell një përgjegjësi për redaksinë e lajmeve të RTK-së për t'u përkujdesur se mbulimi me lajme është gjithëpërfshirës, i matur, i saktë dhe informues.

Në korrik, lajmet kryesore janë zhvendosur nga ora 19.00 në 19.30 dhe dy muaj më vonë dhënjes së lajmeve i është dhënë një pamje më e freskët dhe më moderne për t'u përputhur me standardet europiane të gazetarisë televizive. Poashtu më 14 Maj 2002, RTK-ja prezantoi edicionin e dytë të lajmeve në ora 22.30. 'Blic'-i ka një stil më të ri dhe një ritëm më të shpejtë por pa vënë në rrezik cilësinë redaktoriale dhe vlerat e produksionit.



*Ndarja në përqindje e shikueshmërisë së përgjithshme, 28/ 09 - 11/ 10 2001: Lajmet
Burimi: IREX*

RTK-ja ka zgjeruar mbulimin e lajmeve ndërkombëtare gjatë vitit, duke u ndihmuar për këtë prej korrespondentëve nga një numër i kryeqendrave ndërkombëtare. RTK-ja tani ka hapur edhe byronë e saj në Tiranë. Këmbimi i Lajmeve Regjionale të Europës Juglindore (The South East Europe Regional News Exchange) përdor rrjetin satelitor të EBU-së për këmbimin e përditshëm të lajmeve në mes emetuesve publik në region, dhe kjo i ka mundësuar RTK-së që të rrisë mbulesën e lajmeve në region.

Përveç raportimit mbi çështjet kryesore të ditës, politika redaktoriale e RTK-së i kushton vëmendje poashtu edhe temave që ndikojnë në jetën e përditshme të njerëzve siç janë çështjet sociale, arsimi, shëndetësia, ekonomia dhe puna, siguria dhe ambienti.


Ngjarjet e mëdha të lajmeve rregullisht mbuloohen drejtpërdrejt në programet speciale duke përdorur automjetin për transmetim të jashtëm. Vizita e Presidentit Bush, lirimi i të burgosurve, shpallja e rezultateve të zgjedhjeve, demonstrimi i përkrahjes për ShBA-në pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit janë shembuj ku RTK-ja i sjell ngjarjet publikut në momentin që ato janë duke ndodhur.

Regullorja 2001/13 kërkon që RTK-ja të mbulojë në mënyrë adekuate seancat e organeve kryesore vendimmarrëse. RTK-ja është i vetmi stacion televiziv që ka transmetuar takimet javore të Këshillit Tranzitor të Kosovës. Pas zgjedhjeve, UNMIK-u ka kërkuar nga RTK-ja që të jetë përgjegjëse për transmetimin në television të Kuvendit të ri dhe të gjitha seancat e Kuvendit janë transmetuar drejtpërdrejt. Reporterët e RTK-së kanë marrë pjesë rregullisht në konferencat e UNMIK-ut dhe ato të tjera për shtyp si dhe brifingjet që kanë pasuar takimet e KPA-së.

Gjatë vitit është nxjerrë një Kod i brendshëm Redaktues i Mirësjelljes, për të gjithë stafin e lajmeve dhe programeve për të vendosur politikën redaktuese të RTK-së në çështjet si pavarësia, korrektësia dhe matura, konflikti i interesave, përdorimi i gjuhës, e drejta për intimitet, e drejta për tu trajtuar si i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia dhe standardet e shijes së mirë dhe të mirësjelljes.

Gjatë vitit nuk janë paraqitur ankesa zyrtare për lajmet e RTK-së në Zyrën e Komisionerit të Përkohshëm për Media. Sidoqoftë, në nëntor të vitit 2001, KPM-ja i shkroi RTK-së ku shprehte brengosje për një raport në lajme ku janë dhënë emrat e individëve të akuzuar për një masakër të kryer në vitin 1999. KPM-ja kërkoj që RTK-ja t'i kushtojë vëmendje Kodit të OSBE-së për Mirësjellje të Transmetuesve.






Një ditë e kaluar në dhomën e lajmeve

Çdo ditë tetë reporterë janë jashtë në rrugë së bashku me kameramanët e tyre duke raportuar mbi ngjarjet të cilat i bëjnë lajmet kryesore të orës 19.30. Dita e lajmeve fillon në ora 9 të mëngjesit me një mbledhje të redaksisë e cila shqyrton ngjarjet që priten gjatë ditës dhe i jep detyrat reporterëve. Gjatë ditës Redaktori i Lajmeve përcjell me vëmendje agjencitë e lajmeve dhe internetin që të informojë për njoftimet apo zhvillimet më të reja. Në ndërkohë, Redaktorët e buletineve të lajmeve në gjuhën serbe, turke dhe boshnjake fillojnë të përgatisin buletinin e tyre duke u përqëndruar në ngjarjet që janë të një interesi të veçantë për shikuesit e tyre të ndryshëm. Pasdite, reporterët kthehen në RTK që të fillojnë që të shkruajnë tekstin dhe të bëjnë montazhin e fotografisë. Në studion e kontrollit, pranohen raportet telefonike të korrespondentëve nga jashtë. Dhoma e kontrollit pastaj përgatitet për transmetimin e lajmeve në gjuhën e minoriteteve me Snezhana Çorraj, Fatima Hoxha dhe Nadira Avdiq-Vllasi. Deri më 19.15 prezentuesit e lajmeve kryesore i kanë lexuar tekstet e tyre dhe janë në studio. Lajmet e arritura më vonë janë ende duke u përgatitur në dhomat e montazhit dhe titujt hyrës janë në përfundim. Në orën 19.30 regjisorin e dhomës së kontrollit shfaq titujt hyrës. Edhe një edicion i lajmeve jipet drejtpërdrejt, i shikuar çdo ditë nga më shumë se 700,000 njerëz në Kosovë. Në ora tetë një dorëzim i detyrës nga Redaktori i Lajmeve tek Redaktori i 'Blic'-it. Redaksia e lajmeve ende nuk ka përfunduar punën.

Dhënja e mundësisë për shprehje të gjitha komuniteteve

RTK-ja ka për detyrë që t'iu shërbejë të gjitha komuniteteve dhe ajo është i vetmi televizion me shtrirje në tërë Kosovën që prodhon programe në gjuhën e minoriteteve.

Programi në gjuhën e minoriteteve është zgjeruar gjatë vitit dhe ende është në proces të zhvillimit. RTK-ja ka transmetuar buletin e lajmeve në gjuhën serbe dhe turke gjashtë ditë në javë gjatë tërë vitit. Në korrik, janë shtuar edhe lajmet në gjuhën boshnjake me shërbim të ngjashëm gjashtë-ditë në-javë të përgatitur nga punëtorët e rinjë që janë redaktori dhe gazetari boshnjak.



Ndarja në % e shikueshmërisë së përgjithshme: Lajmet në gjuhën e minoriteteve, 28/ 09 - 11/ 10

Burimi: IREX

Në të njëjtin muaj magazinat javore të lajmeve në gjuhën serbe dhe turke janë zgjeruar në kohë ndërsa programi javor në gjuhën boshnjake do të fillojë në gjysmën e vitit 2002.

Ekipi raportues serb është i vendosur në Graçanicë dhe funksionon si pjesë e integruar e redaksisë së lajmeve duke raportuar nga komunitetet serbe në tërë Kosovën për shërbimet e lajmeve në të gjitha gjuhët.

Një protokol për këmbimin e lajmeve në mes transmetuesit publik turk TRT dhe RTK-së është nënshkruar në shtator të vitit 2001 ndërsa këmbimet rajonale të programeve për shërbimet në gjuhët e tjera janë nën shqyrtim aktiv.

Në bazë të Rregullores 2001/13 RTK-së i kërkohet që t'i kushtojë jo më pak se 15% të kohës kryesore të lajmeve, lajmeve në gjuhët e tjera prej asaj shqipe si dhe jo më pak se 15% të programit të përgjithshëm.





Buletinet e lajmeve në gjuhën serbe, turke dhe boshnjake përbëjnë 26% të transmetimit në kohën kryesore të lajmeve që është gati dyfishi i kërkesës që bëhet në Rregullore.

Programi i tërësishëm në gjuhën e minoriteve përbënte 7% të programit në fillim të vitit por ekspansioni i programit e ka ulur në 4% në fund të vitit dhe kjo është një fushë prioritare për përmirësim në vitin 2002.

Programi në gjuhët e minoriteteve është një nga aspektet e angazhimit të RTK-së për komunitetet joshqiptare. Temat mbi minoritetet poashtu shfaqen rregullisht në lajmet kryesore të mbrëmjes dhe në rrjedhën kryesore të programit në gjuhën shqipe. Lajmet e orës 7.30 kanë raportuar për çështjet si shkollat e përziera shqiptaro-turke, problemet me të cilat ballafaqohet komuniteti goran, marrëdhënjet mes komuniteteve në Letnicë, kampi i romëve dhe hashkalive afër Obiliqit si dhe bashkangjitja e minoriteteve në TMK-ë. RTK-ja përkujdeset që të raportojë për zhvillimet pozitive si dhe për fushat në të cilat vazhdohet që të haset në vështirësi.

Programet e tjera përfshijnë debatin e drejpërdrejtë në mes Adem Demaçit dhe Rada Trajkoviqit si dhe përfshirjen e përfaqësuesit të Povratak-ut në ditën e fundit të fushatës zgjedhore. Në transmetimet e drejpërdrejta të Këshillit Tranzitor të Kosovës dhe të Kuvendit të ri, RTK-ja ka qenë i vetmi television ku deputetët joshqiptarë janë dëgjuar duke folur në gjuhën e tyre pa përkthim.


Televizioni dhe radioja e suksesshme varen nga bashkëpunimi dhe këmbimi i informatave dhe shërbimet në të gjitha gjuhët të punojnë së bashku në të njëjtën dhomë të lajmeve.

RTK-ja gjatë vitit 2001 është përkrahur nga OSBE-ja me dhënjën në përdorim të veturës së saj, gjë që i ka mundësuar çasje dhe kalim të sigurtë për ekipet e minoriteteve gjatë mbledhjes së lajmeve dhe informatave.

Programi për fëmijë dhe për të rinjë

Programi për fëmijë në pasditen e vonë është rritur nga gjysmë ore në një orë gjatë vitit 2001, si pjesë e politikës së RTK-së për ndërtimin e një vargu të programeve atraktive për fëmijë, ku kombinohen elementet e argëtimit, involvimit, veprimtarisë kreative dhe edukimit.


RTK-ja bën tre programe për fëmijë çdo javë: 'Kutia Magjike', 'Fjolla' dhe 'Fëmijët Këndojnë'. RTK-ja, poashtu, është duke marrë programe të animuara të cilësisë të lartë nga EBU-ja dhe Canal France International dhe këto dublohen nga aktorët e Teatrit Dodona. Një program tjetër për fëmijë, që është duke u dhënë për një kohë të gjatë, është 'Kasperle' nga ORF, transmetuesi publik austriak.



*Ndarja në % e shikueshmërisë së përgjithshme: Programi për fëmijë dhe të rinjë, 28/ 09 - 11/ 10
Burimi: IREX*

RTK-ja ka themeluar departamentin e programit për të rinjë gjatë vitit 2000 duke pasur në mendje dy qëllime: që të mundësojë që programet për shikuesit e moshës së re të bëhen nga moshatarët e tyre dhe që të zhvillojë një rezervë të talentëve për rekrutim të ardhshëm në poste kadrovike në RTK. Ekipi i të rinjve prodhon emisionin javor të popullarizuar 'Amazing Be'Njeri', që mbulon çështje dhe tema me interes për moshat nën 25 vjeç. Në fillim të vitit 2002, është filluar me një debat të ri javor për të rinjët ku ata kanë mundësi që të merren me mysafirët ekspertë të fushave të ndryshme që nga edukimi seksual e deri te cilësia e mësimin në shkolla.





Fatmir Hoxha
Skulptor



Arti dhe Kultura

Në bazë të Rregullores 2001/13, nga RTK-ja kërkohet që të përkrah zhvillimin kulturor dhe të shprehë llojllojshmërinë kulturore në Kosovë.

Kjo është bërë nëpërmes programeve të posaçme për artin dhe nëpërmes mbulimit të rregullt në lajme. Ngjarjet kryesore të vitit në kulturë dhe art janë mbuluar në masë të mjaftueshme në lajme, përfshirë lajmet në gjuhën e minoriteteve. Ngjarjet kulturore janë paraqitur në lajme mesatarisht në gjashtë nga shtatë ditë.


Programi kryesor për artin është 'Kult-i', një mozaik që pasqyron të gjitha format kulturore që nga fjala e shkruar e deri te arti vizual, ekzibicionet, seminarët, bisedat me artistë dhe shkrimtarë, dokumentare mbi artin si dhe tubimet për intelektualët e shquar të ndjerë. Poashtu ka pasur një llojllojshmëri të programeve të kohëpaskohshme - përfshirë shumë prezente të drejpërdrejta - të koncerteve, shfaqjeve teatrale dhe të ansambleve amatore dhe profesionale. Programet e rregullta si 'Intervista e Javës' dhe 'Sinqeritet-i' poashtu prezentuan ata që janë të përfshirë në art dhe kulturë.

Në fillim të vitit 2002 është prezentuar një program i ri që realizohet në studio për artin e që i dedikohet debatit të gjerë kulturor.

Programet e huaja, sidomos nga 'Arte', begatuan programin kulturor të RTK-së. 'Palettes' ka qenë një seri e dyzet e pesë programeve që hedhën shikim në punën e piktorëve më të mëdhenj botërorë. 'Contacts' mbi fotografinë botërore, 'World Music Collection' dhe 'Le Legende' mbi shkencën, të gjitha këto ishin të bëra në bazë të standardeve më të larta të produksionit dhe ishin një shtesë e mirëpritur në skemën programore.

Programi informativ


RTK-ja ka shtuar numrin e titujve të programeve informative gjatë vitit 2001. Programi informues dhe i lajmeve për bujqit dhe fshatin ka filluar në korrik. 'Bujku' raporton nga vendi i ngjarjes për një numër të madh të çështjeve që kanë të bëjnë me bujqësinë dhe kjo është menduar për të ndihmuar dhe për të përkrahur ata që fitojnë mjetet e jetesës nëpërmes bujqësisë. Në të njëjtin muaj, ka filluar Programi i ri për Biznesin që mbulon temat që kanë të bëjnë me biznesin dhe ekonominë në mënyrë përkrahëse dhe të arritshme. 'Medika' është një program dyjavor këshillues mjekësor ku përdoren mysafirët ekspertë për të ofruar këshilla shëndetësore. Programi ka një vlerë të veçantë për familjet në regionet rurale të cilat nuk e kanë të lehtë qasjen në informata mjekësore. Temat familjare dhe ato sociale paraqiten në programin javor diskutues në studio 'Ngjyra jete'. Lidhja e afërt me diasporën e Kosovës nëpërmes shërbimit satelitor të RTK-së ka inkurajuar RTK-në që të fillojë me një program javor që i kushtohet posaçërisht shikuesve nga diaspora. Programi është një kombinim i diskutimeve dhe informimit i plotësuar nga vizitat e kohëpaskohshme jashtë vendit nga reporterët e programit për të pasqyruar aspekte të jetës së përditshme të kosovarëve që jetojnë dhe punojnë në vendet e tjera.



*Ndarja në % e shikueshmërisë së përgjithshme: Bujku, 28/ 09 - 11/ 10
Burimi: IREX*

Seritë e huaja përfshinë 'Gjashtë Eksperimente që Ndryshuan Botën' nga Channel 4 si dhe seritë e shkëlqyeshme mbi udhëtimet të quajtur 'Udhët', poashtu nga Channel 4.





RTK ka një obligim që të përfshijë programe që janë me interes për regionet e ndryshme të Kosovës. Magazina javore e lajmeve në gjuhën serbe rregullisht raporton prej komuniteteve të serbëve të Kosovës edhe pse mbulesa e Mitrovicës veriore dhe Kosovës veriore është kufizuar deri më tani për arsye sigurie. Magazina javore në gjuhën turke bën reportazhe çdo javë mbi komunitetet turke anembanë Kosovës. Programet gazetareske javore si dhe magazina për bujqësi dhe çështje rurale "Bujku" pasqyrojnë aktivitetet në këtë fushë nga të gjitha regionet e Kosovës. Regjionet poashtu në mënyrë specifike janë prezentuar në debatet politike gjatë fushatës zgjedhore. RTK-ja ka transmetuar 12 "Debate me qytetarët" nga të gjitha pjesët e Kosovës, ku shikuesit i kanë bërë pyetje të dretpërdrejta politikanëve lokal në të shumtën e rasteve mbi çështjet dhe problemet lokale.. Një seri e transmetimeve gjatë vitit 2001 u quajt 'Ne prezentojmë' e i cili ka qenë një dokumentar gjysmëorësh ku u portretizuan qytetet kryesore të Kosovës.

Shërbimi satelitor

Është vështirët të dihet numri i shqiptarëve të Kosovës që jetojnë jashtë duke marrë parasysh përkohshmërinë dhe shtrirjen gjeografike të migracionit para, gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999. Letrat, emailat dhe thirrjet telefonike nga e tërë Europa prej shqiptarëve të Kosovës e vërtetojnë rëndësinë dhe popullaritetin e shërbimit satelitor të Kosovës. Sidomos vlerësohen lajmet dhe informimi nga Kosova ndërsa lavdërime të veçanta ka marrë çasja e programit për fëmijë në gjuhën shqipe. RTK-ja transmeton në shërbimin satelitor një numër të madh të programeve vendore. Poashtu ka edhe një program që i përkushtohet shikuesve në diasporë. Ky program përqëndrohet në çështjet që kanë të bëjnë me atë sesi është të jeshë shqiptarë i Kosovës që jeton dhe punon në botën e jashtme. Programi satelitor do të zgjerohet aq sa e lejojnë resurset pasi që transmetimi nëpërmes satelitit është në dispozicion gjatë tërë 24 orëve. Aktualisht, skema programore e televizionit satelitor përbëhet nga 9 orë program dhe gjatë 15 orëve të tjera transmetohet drejtpërdrejtë programi i Radio Kosovës. Shërbimi satelitor i RTK-së mund të gjindet në Eutelsat W2. Ne transmetojmë përmes televizionit kabllovik në një numër shtetesh që nga Suedia e deri te Sllovenia.

Diskutimi dhe debatet

RTK-ja ka obligim që të kontribuojë në debatin informativ dhe mendimin kritik.


Aktualisht, programi 'Drejpëdrejt' që jipet çdo të marte është programi kryesor i diskutimeve në studio mbi çështjet serioze të RTK-së. Transmetohet në kohën më të ndjekur menjëherë pas lajmeve kryesore. Mysafirët gjatë vitit 2001 përfshinë PSSP-në, Kryetarin e Kuvendit, ZPSSP-në për OSBE-në dhe BE-në, Shefin e Zyrës së ShBA-së, liderët e partive politike si dhe politikanët e tjerë të shquar dhe formuesit e opinionit, ndërkombëtarë dhe vendor si dhe nga të gjitha komunitetet. Një karakteristikë e emisionit 'Drejpëdrejt' është mundësia për opinionin në Kosovë dhe jashtë saj për t'i bërë pyetje mysafirëve në studio.

Një program tjetër i rëndësishëm është programi javor "Pro et Contra" e i cili ka filluar në korrik të vitit 2001. Siç mund të kuptohet edhe nga emri, merr çështje kontraverze dhe hulumton të gjitha mendimet, pjesërisht përmes raporteve të filmuara por poashtu edhe përmes debatit në studio ku palët kundërshtuese argumentojnë rastet e tyre.

'Intervista e Javës' është një bisedë një me një me personalitete që kanë qenë në lajme. 'Ngjyra jete' është një diskutim i drejpëdrejtë në studio mbi temat familjare dhe sociale.

Pashtu ka pasur edhe numër të debateve të jashtëzakonshme në përgjigje të ngjarjeve të mëdha si problemet në Maqedoni, zhvillimet politike në Serbi si dhe sulmi terrorist i 11 shtatorit në ShBA.

Debatet politike kanë qenë një pjesë e rëndësishme e transmetimeve për zgjedhjet e vitit të kaluar. Një debat gjysëmorësh është mbajtur çdo ditë gjatë fushatës zgjedhore ku çdo debat ka përfshirë së paku tre përfaqësues të partive politike. Në periudhën përgatitore për zgjedhjet një koproduksion javor me OSBE-në 'Kamera në Zgjedhje' ka ofruar informata mbi zgjedhjet nëpërmes raporteve të filmuara dhe debateve në studio. Një program i ngjashëm 'Kamera në Regjistrim' ka ofruar informata për votuesit mbi procesin e regjistrimit.



Ndarja në % e shikueshmërisë së përgjithshme: Zgjedhjet, 28/ 09 - 11/ 10
Burimi: IREX





Muzika dhe argëtimi

Muzika dhe argëtimi përfshijnë një numër të zhanreve programore dhe përbëjnë një pjesë të rëndësishme të programeve vetanake të RTK-së. Programet muzikore shtrihen që nga ato popullore, muzika moderne deri te ajo klasike dhe tradicionale. Programe përfshijnë "RTK Sound", "Kurora Muzikore", "Fundjava me ne" si dhe "Ritme Folklorike". RTK-ja ka inqizuar apo ka transmetuar drejtpërdrejt një numër të festivaleve dhe koncerteve, në mes tyre 'Showfest' dhe 'Polyfest'.

Një seri pesëjavore e koncerteve të drejtpërdrejta në mbrëmje, "Pesë mbrëmje në Prishtinë", ishte organizuar nga RTK-ja dhe është transmetuar nga një skenë posaqërisht e konstruktuar në bazenin e Gërmisë. Aty janë paraqitur shumë nga këngëtarët dhe grupet më të njohura të Kosovës.

Në mes programeve argëtuese në RTK-ë 'Ditari i Stupcave' është një nga më të popullarizuarit. Skeçet e saj humoristike dhe satira e butë tregojnë një ndjenjë të shëndoshë të mundësisë për të qeshur edhe për çështjet më serioze. 'Trigger Happy TV' nga Channel 4 i ka sjellur edhe më tepër humor skemës programore.

Programi i lehtë argëtues i të së shtunës në RTK është një ngjarje e shikueshmërisë së lartë. Gjatë kohës më të madhe të vitit 2001 programi është prezentuar nga Armendi dhe Aida, dy nga artistët muzikorë më të njohur në Kosovë.


"Mirëmbrëma Prishtinë" është një kombinim argëtues i bisedës, muzikës, artit dhe argëtimit. Shou i mbrëmjes së vonë "Sinqeritetet" u përqëndrua në bisedat joformale dhe humoristike me një shtrirje të gjerë të personaliteteve. Programi i Vitit të Ri ka qenë një ndër prodhimet kryesore muzikore dhe argëtuese të RTK-së, me një program disaditor të posaçëm.

Sporti

Sporti ofron një shkarkim për energjinë dhe pasionet dhe transmetimi i sportit ndërkombëtar është një lidhje e mirëpritur me botën e jashtme. Për entuziastët e sportit, mundësia për të ndjekur ekipin e tyre nëpërmjet transmetimit të drejtpërdrejt paraqet një pjesë të vlefshme të programit televiziv. Njësia e sportit të RTK-së është përgjegjëse për lajmet ditore sportive, për programin sportive të së dielës 'Pasqyra e Sportit' si dhe për komnetimet e drejtpërdrejta.

Zhvillimi kryesor gjatë vitit të kaluar ka qenë shtimi i numrit të transmetimeve të drejtpërdrejta sportive. Falë EBU-së, RTK-ja ka transmetuar Super Kupën e UEFA-së dhe Finalen e Kupës së UEFA-së, të cilët poashtu kanë mbuluar shpenzimet teknike për transmetimin e Finales së Ligës së Kampionëve dhe disa ndeshjeve kualifikuese për Kampionatin Botëror. RTK-ja ka mbajtur të drejtën ekskluzive për transmetim të disa nga klubet e basketbollit të Kosovës si dhe të Premier Ligës angleze duke iu mundësuar në këtë mënyrë dashamirëve të futbollit të shohin ekipet si Manchester United dhe Liverpool.

Transmetimet e tjera të drejtpërdrejta përfshinë Kampionatin Europian në boks me boksierin kosovar Luan Krasniqi si dhe meçin e boksit mes Kosovës dhe Shqipërisë e poashtu edhe disa ndeshjet e klubeve hendbollistike të Kosovës.



*Ndarja në % e shikueshmërisë së përgjithshme: Futbolli i Premier Ligës së Anglisë, 28/09 - 11/10
Burimi: IREX*

Transmetimet e drejtpërdrejta dhe ngjarjet kryesore të ditës nga Lojërat Olimpike Dimërore kompletuan vit të larmishëm dhe të suksesshëm të sportit në RTK.





Ngjarjet e veçanta

Një paraqitje që u shqua në vitin 2001 ishte vëmendja e madhe që RTK-ja i kushtoi transmetimeve të drejtpërdrejta të lajmeve kryesore si dhe rasteve të veçanta. Ripajisja teknike e RTK-së në fillim të vitit përfshiu veturën për Transmetim të Jashtëm me katër kamera donacioni i qeverisë së Japonisë. Vetura është përdorur në masë të gjerë për programet e drejtpërdrejta, raportimet e drejtpërdrejta të lajmeve dhe për inqizimin kompleks të programeve në lokacione. Ngjarjet që janë transmetuar gjatë vitit kanë qenë:


- Mbulimi i Transmetimit të drejtpërdrejtë nga Gjykimi i Hagës
- Takimet javore të Këshillit Tranzitor të Kosovës
- Të gjitha takimet e Kuvendit të ri
- Vizita e Presidentit Bush në Camp Bondsteel
- Festimet e 4 korrikut në zyrën e ShBA-ve
- Shpallja e rezultateve të zgjedhjeve nga OSBE-ja
- Mesha e Krishtlindjes nga Kisha Katolike
- Falje e Bajramit nga Xhamia Qendrore
- Ngjarjet sportive përfshirë ndeshjet basketbollistike të Kosovës dhe kikkoksi ndërkombëtar
- Festalet muzikore përfshirë Showfest-in, Polyfest-in

Shqyrtimi i vitit - Radio

RTK i ofron dëgjuesve dy stacione të shërbimit publik, çdonjëra nga to me stilin dhe çasjen e veçantë dhe me dëgjues të ndryshëm.

Radio Kosova ka më shumë një stil tradicional dhe tërheq më së shumti dëgjuesit e moshës mbi 30 vjeç me kombinim të butë të muzikës, lajmeve, informimit, diskutimit dhe kulturës. Në valët e mesme jipet çdo ditë program një orësh në gjuhën turke. Radio Blue Sky padyshim është një stacion i ri i menduar për dëgjues të moshës nën 30 vjeç me më shumë theks në muzik, shou muzikore të profesionistëve dhe me një qasje të arritshme dhe të nivelizuar të lajmeve dhe të informimit.

Lajmet janë komponenta kryesore e të dy stacioneve, dhe ajo që e bën RTK-në më së shumti të menjëhershme është shërbimi i lajmeve që i jep ato shpejtë dhe që kanë të bëjnë deri me momentin e fillimit të dhënjes së lajmeve të cilat gjerësisht perceptohen të jenë të vërteta, të pavarura dhe të paanshme. Radio Kosova poashtu ofron lajme dhe analiza të thelluara.




Pjesa e dëgjuesve të Radios së RTK-së
Burimi: IREX

85 radio stacione janë të licencuara nga Zyra e Komisionerit të Përkohshëm për Media ku 81 nga këto janë radio stacione vendore dhe ato me fuqi të vogël. Përveç këtyre, nga kjo zyre janë licencuar edhe katër transmetues ndërkombëtar (BBC, VOA, DW dhe RFI) si dhe 33 radiostacione të KFOR-it. (Burimi: Divizioni i OSBE-së për Rregulloret, Ligjet dhe Standardet e Mediave)





Anketa e IREX-it mbi dëgjueshmërinë të bërë në shtator ka treguar se Radio Kosova është në vendin e dytë ndërsa Blue Sky në vendin e pestë ndër stacionet kosovare, në një treg shumë konkurrues . Në një ditë tipike 245,000 njerëz dëgjojnë Radio Kosovën dhe 71,000 Radion Blue Sky e cila në mënyrë specifike si objektiv ka dëgjuesit nën 30 vjeç.



*Përqindja e ndjekjes mesatare nga dëgjuesit shqiptar
Burimi: IREX*

Radiot e RTK-së i ofrojnë dëgjuesve pranim nëpërmes internetit, i cili është i mundshëm për të dy stacionet nëpërmes faqeve të tyre në internet www.radio-kosova.com dhe www.blueskylive.com. Radio Kosova ka 2000 vizitorë në ditë dhe koha mesatare e dëgjimit është 21 minuta.

Zhvillimi Programor


Programet e Radio Kosovës dhe Radios Blue Sky janë produksion 100% vendor. Pas pranimit të informacionit nga dëgjuesit, Radio Kosova ka prezentuar një skemë të re programore me përmbajtje tërësisht të re dhe me një numër të veçorive. Anketimi i dëgjuesve ka

treguar se është zgjedhur rruga e drejtë.

Si Radio Kosova poashtu edhe Blue Sky besojnë në promovimin e talenteve të reja në të gjitha zhanret e transmetimit në radio. Politika programore duhet të pasqyrojë shtrirjen e kompetencave të RTK-së si shërbim publik dhe të dy radiostacionet e RTK-së luftojnë që të prodhojnë program të kualitetit të lartë me një tërheqje masive dhe profesionale.

Lajmet dhe informimi

Një nga elementet e përforcuara në të dy radiot është programi i tyre i lajmeve. Gjatë vitit janë bërë ndryshime të një shkalle të gjërë në të dy radiostacionet. Përpjekje të veçanta janë bërë në azhurimin e rregullt të lajmeve të orës. Një rishikim i brendshëm tregon se 60% të çdo transmetimi të lajmeve janë lajme të reja apo të azhuruara. Shërbimi i lajmeve funksionon nga ora 6 në mëngjes deri në mesnatë.



Përqindja e zhanreve Programore: Radio, 28/ 09 - 11/ 10
Burimi: IREX





Anketa e dëgjuesve tregoi se emisioni kryesor i lajmeve në Radio Kosovë, Ngjarjet e ditës, dyfishon numrin e dëgjuesve përderisa Specialja e Ditës në emisionin kryesor të lajmeve në Blue Sky i sjell dëgjuesve një gazetari të hulumtuar mirë mbi çështjet e mprehta si krimi i organizuar.

Një përmirësim i rëndësishëm u bë me prezentimin në Radio Kosovë të programit të lajmeve Aktualitete, që mirret me ngjarjet ditore nëpërmes intervistimit të analistëve dhe të pjesëmarrësve.

Radio Kosova dhe Radio Blue Sky gradualisht kanë bashkuar resurset e tyre për mbledhjen e lajmeve. Kjo ka përmirësuar në masë të rëndësishme cilësinë e lajmeve në të dy stacionet. Këmbimi konstant i storieve, koordinimi ditor dhe përqëndrimi i planifikimit të përbashkët nënkuptojnë lajme më të mira dhe më shumë transmetim me të njëjtat resurse.

Në pranverë të vitit 2001, Radio Kosova dhe Radio Blue Sky u paraqitën me një format të ri të programit të mëngjesit, të emëruar Mirëmëngjesi Kosovë dhe Mëngjesi Blu. Muzikë e mirë, shërbimi i informimit, shqyrtimi i shtypit, reporterët në rrugë dhe korrespondentët nga e tërë Kosova e bëjnë tërheqës programin e ri në një kohë të rëndësishme të ditës sa i përket dëgjueshmërisë së radios. Telefonatat e shumta të dëgjuesve të cilët kërkojnë ndihmë nga kompanitë publike si KEK-u (rryma), PTK-ja (telefonat), Batllava (uji), dhe Higjienoteknika (mbeturi-nat) janë dëshmi e besimit të dëgjuesve tanë në radiot e RTK-së.

Dhënja e mundësisë për shprehje për të gjitha komunitetet

Radio Kosova dhe Radio Blue Sky janë të angazhuara në programe për minoritete.

Blue Sky transmeton çdo ditë një orë e gjysëm në ditë në gjuhën serbe programe të lajmeve dhe magazinës të cilat mirren me çështjet me të cilat ballafaqohet komuniteti serb.

Blue Sky transmeton një orë në ditë në gjuhën turke e poashtu edhe Radio Kosova ka pro-

gramin e saj një orësh në gjuhën turke në valë të mesme.

Redaktorët dhe gazetarët e shërbimeve në të gjitha gjuhët punojnë së bashku në dhomën e lajmeve. Storit këmbehen rregullisht në mes ekipeve të gjuhëve të ndryshme dhe çdo ekip inkurajohet që të kuptojë pikëvështrimin e të tjerëve dhe të jenë kritik por edhe objektiv në raportimin për komunitetin e tyre. RTK-ja është multietnike si në ambientet e saja të punës si edhe në programet e saj.

Të dy shërbimet në gjuhët e minoriteteve kanë korrespondentë që raportojnë nga regjionet e popullatës minoritare. Ekipi turk është duke përfutur nga protokoli i nënshkruar në mes RTK-së dhe TRT-së. Departamenti turk është duke e përdorur protokolin për të marrë muzikë, paraqitje dhe reportazhe të fëmijëve nga sateliti i TRT-së.

Sporti

Radio Kosova përgjithësisht mirret si radio stacioni numër një në Kosovë sa i përket sportit.

Ka transmetuar dretpërdrejt të gjitha ndeshjet e basketbollit dhe futbollit në vitin 2001 me një ekip të komentatorëve me përvojë përfshirë ndeshjen finale për kup në mes ekipeve të basketbollit të Prishtinës dhe Trepçës ku e fundit u kurorëzua si kampionë.

Magazina Sportive, një segment sportiv në ora 19.30 brenda lajmeve kryesore të mbrëmjes i ka dhënë dëgjuesve tanë storie ekskluzive nga sporti vendor dhe ai ndërkombëtar.

Nata Sportive, një magazinë javore sportive që transmetohet të mërkureve në ora 22.00, paraqet biseda, analiza dhe vizitorë që i bashkangjiten prezantuesit dhe është treguar të jetë mjaft e popullarizuar si dhe pasqyruese e përmirësimit të skemës sportive të Kosovës.

Pjesëmarrja në masë në ndeshjet e basketbollit dhe futbollit tregon se ka një numër të madh të tifozëve entuziast të cilët kanë nevojë për një forum për debate dhe komente. Radio Kosova u ka ofruar këtë atyre. Sport Billy në Blue Sky është poashtu një vend ku njerëzit mund të shprehin mendimet e tyre ndonëse ky është më tepër një talk shou zbavitës por i mprehtë që mëton plotësimin e nevojave të dashamirëve të sportit që i përkasin gjeneratave më të reja.





Programet e bazuara në fakte

Radio Kosova dhe Radio Blue Sky kanë që të dyja programe të fuqishme të bazuara në fakte. Pasi që shumica e popullatës janë të përfshirë në bujqësi, Radio Kosova ka filluar në fillim të vitit 2001 një program për bujqësinë. “Emisioni për Bujqësi” është një program i bazuar në paraqitje me një theks të fuqishëm në këshillën e pavarur dhe në shqetësimet të cilat ata i kanë.

Një shou tjetër i popullarizuar është “Gruaja Sot”, një shou që diskuton çështjet që u përkasin grave. Kjo është një pjesë e rëndësishme e përgjegjësisë së RTK-së si shërbim publik posaqërisht pasi që femrat janë në numër më të madh se meshkujt në Kosovë.

“Medika”, si edhe homologia e saj në televizion, informon dëgjuesit mbi çështjet mjekësore, edukimin shëndetësor, programin shëndetësor dhe për këshillat. Mjekët, kirurgët, punëtorët shëndetësorë dhe të tjerët i bashkangjiten prezantuesit në studio për të diskutuar dhe për të pranuar telefonata nga dëgjuesit.

Të gjitha këto zhanre programore kanë gjetur kohë që të debatohen në “Vala 91.9”, një shou i drejtpërdrejtë i Radio Kosovës me mysafirë të çështjeve sociale dhe atyre të mirëqenjes.

Muzika

Blue Sky është shtëpia e muzikës moderne dhe të popullarizuar në Kosovë. Katalogu i saj muzikor vazhdimisht është azhuruar gjatë vitit 2001 për tu siguruar se dëgjuesit e moshës së re janë duke dëgjuar ritmet më të reja.

“Sky Top 20”, që transmetohet gjatë vikendit në Blue Sky, ka tërhequr një numër të madh të dëgjuesve ku transmetohen inqizimet më të dëguara të javës, gjë të cilën e bën edhe Radio Kosova me shoun e ngjashëm të saj “Top Kosova”.

Shou i shkëlqyeshëm dhe i popullarizuar i muzikës alternative dhe kulturës, “Pilot Underground”, iu ofron dëgjuesve këngët nga grupet të cilat në masë të konsiderueshme kanë munguar në skenën muzikore këtu gjatë viteve të '80 dhe të '90, si dhe nga grupet më të reja të pavarura. “Danny Boy”, shërben veprat më të mira të hip hop-it të ShBA-së, R n' B-së, si dhe veprat e

reperëve vendorë. Ky është një zhanër i popullarizuar i muzikës posaqërisht pasi që ekziston një talent i begatshëm vendor.

Radio Kosova ka dëshmuar se nuk ka në objektiv vetëm dëgjuesit e moshës më të vjetër me shou muzikore të muzikës për të rinjtë si “Në Ritëm të Këngës” dhe shou i kërkesave, “Dëshirat e Dëgjuesve”. Dëgjuesit e “Kolorite Dashurie” janë trajtuar me përzgjedhje të muzikës romantike pas mesnatës.

Radio Kosova transmeton më tepër muzikë tradicionale me një kombinim të shëndetshëm të muzikës popullore dhe asaj klasike nga arkivi i Radios së RTK-së.

Talk Shou

Blue Sky ka dhënë disa shou me biseda ku janë përdorur si telefoni poashtu edhe e-maili për të sjellur dëgjuesit në valë të transmetimit. “No-Name Show” i ka mundësuar dëgjuesve që të komunikojnë me prezantuesin nëpërmjet një adrese të posaçme të e-mailit në MSN Messenger, si dhe “Fresh at Night” ka mundësuar që të diskutohen më tepër tema tabu. Të dy këto programe janë treguar të jenë posaqërisht të popullarizuara në diasporë me telefonatat dhe e-mailat që vijnë nga të gjitha anët e botës. Lidhja me diasporën është një pjesë e vlefshme e shërbimit të radios të RTK-së.

Ngarjet Speciale

Bashkëpunimi mes radios dhe televizionit i ka dhënë radios çasje në një numër të ngjarjeve të drejtpërdrejta si vizita e Presidentit Bush në Kosovë, lirimi i të burgosurve kosovarë, në të gjitha sesionet e Kuvendit si dhe në konferencat për shtyp dhe rezultatet e zgjedhjeve.


Të dy radiot kanë drejtuar një program special gjatë fushatës zgjedhore. Debatet e përditshme mbajtën dëgjuesit të informuar me çështjet e fushatës. Transmetimet e partive politike janë bërë në pajtim me rregulloret e OSBE-së. Në programet kryesore të lajmeve janë përfshirë blloqe speciale të mbulimit të zgjedhjeve si dhe ka pasur një përmbledhje gjithëpërfshirëse të aktiviteteve zgjedhore çdo mbrëmje. Si një përfundim i fushatës, radio organizoi një debat të drejtpërdrejt publik në Qendrën e Rinisë në Prishtinë i cili u transmetua edhe nga televizioni.





Financimi i RTK-së

Të hyrat primare të RTK-së në vitin 2001 kanë qenë nga përkrahja e donatorëve; kjo është plotësuar nga të hyrat komerciale që kanë rrjedhur nga reklamimi gjatë transmetimit dhe nga sponsorimi, nga dhënja me qira e objekteve dhe nga të hyrat nga transmetuesit e jashtëm të cilët përdorin pikën ushqyese në satelit për këmbimin e lajmeve në Eurovizion.



*% e shpenzimeve të përgjithshme për t'u bartur nga donatorët, 28/ 09 - 11/ 10
Burimi: RTK*

Si transmetues publik, RTK-ja beson se të hyrat primare do të duhej të jenë nga financimi publik. Një formë e parapagimit për transmetuesin publik është njëra nga mënyrat e zakonshme të financimit të transmetuesit publik dhe politika e UNMIK-ut është që të zbatohet pagesa për transmetuesin publik të Kosovës.

Grupi Punues për Financimin e RTK-së i udhëhequr nga shtylla e BE-së ka raportuar në janar të vitit 2002. Ai ka arritur në përfundim se RTK-ja do të duhej të përkrahej nga pagesa për transmetuesin publik dhe se KEK-u do të duhej të ishte agjencia mbledhëse e parapagimit. Grupi Punues poashtu erdhi në përfundim se RTK-ja do të duhej të financohej nga Buxheti i

Konsoliduar i Kosovës vetëm për vitin 2002 përderisa të fillohet me pagesën për transmetuesin publik. Si edhe shumica dërrmuese e transmetuesve publik në botë, RTK-ja i plotëson të hyrat e saja publike me të hyra komerciale përmes reklamimit, sponsorimit dhe aktiviteteve përkrahëse. Financimi i përzier i kësaj natyre është një normë për transmetuesit publik, posaçërisht në vendet që nuk mund të përkrahin ekonomikisht një nivel të lartë të pagesës për transmetuesin publik.

RTK-ja e pranon se kur pagesa për transmetuesin publik të ofrojë të hyra të sigurta dhe të konsiderueshme do të duhej të zbatoheshin disa kufizime për reklamimin e përgjithshëm në shërbimin terestrial siç ndodh në shumë vende.

Sidoçoftë, duhet të dihet se të ardhurat në vitin 2002 pritet të jetë më pak se shuma e gjysmës së vitit 2001 dhe do të përfshijë rreth 35% të të ardhurave të RTK-së. Të ardhurat e donacioneve në vitin 2003, viti i parë i pagesës së transmetimit publik, pritet të përgjysmohet.


Shqyrtimi Fianciar

Plani i Punës për vitin 2001 është miratuar nga OSBE-ja në dhjetor të vitit 2000 me përrirjen e Memorandumit të Mirëkuptimit në mes OSBE-së dhe EBU-së për vitin 2001.

RTK-ja prezantoi para donatorëve Planin e Punës dhe shprehu mirënjohjen për përkrahjen e pranuar gjatë vitit nga Agjencia Europiane për Rindërtim, Agjencia Zvicërene për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar (Britani e Madhe), Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, Qeveria e Holandës dhe Qeveria e Norvegjisë. RTK-ja poashtu falenderon për përkrahjen financiare në mbulimin e zgjedhjeve nga DfID-i dhe AER-i. RTK-ja shpreh mirënjohje për donacionin zemërgjërë nga Qeveria e Japonisë në ripajisjen teknike e cila është përfunduar në fillim të vitit 2001.

Deri në fund të vitit 2001 RTK-ja ka përfituar nga lehtësira parafinancuese e siguruar nga EBU-ja.





Hapësirat e hargjimeve në %, Burimi: RTK

Që nga viti 2002 kjo lehtësirë nuk është më në disponim. RTK-ja ndjek një politikë të kontrollit për shpenzim të kujdesshëm dhe lufton që të japë shërbim që e ka vlerën e të hollave të dhëna. Metodët e kontabilitetit janë në përputhshmëri me rregulloret përkatëse. Departamenti i Financave nxjerr llogaritë mujore të menagjimit. Ekzistojnë procedura strikte të shpenzimeve dhe çdo shpenzim mbi 1,500 Euro duhet të miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Veçoria kryesore e vitit 2001 ka qenë se televizioni ka redukuar shpenzimet e planifikuara në Planin e Biznesit për 24% edhe pse iu përmbajt në tërësi programeve të veta zhvillimore. Pjesërisht, kjo ishte një masë e domosdoshme sepse parashikimi i Planit të Biznesit për të hyra në masën 675,000 Euro nga pagesa për transmetuesin publik nuk u materializua pasi që pagesa për transmetuesin publik u shtye. Shpenzimet e përgjithshme në fund të vitit kanë qenë 9,275,616 DM për televizionin dhe 2,263,426 DM për radion. Shpenzimet janë mbuluar nga të hyrat prej donacioneve dhe të hyrat shtesë komerciale dhe në këtë mënyrë RTK-ja përfundoi vitin me një tepriçë të vogël.

Revizioni i vitit 2001 ka qenë i kontrolluar nga EBU-ja e stacionuar në Gjenevë, dhe atë në dy revizione të ndara lokale për radion dhe televizionin.

Përkundër vazhdimit të zhvillimit gjatë vitit 2002, Plani i biznesit për vitin 2002 parashikon shpenzime më të ulëta se Plani i biznesit për vitin 2001, indikacion ky se RTK-ja vazhdon të drejtohet kah efikasiteti.

Logaritë e të hyrave dhe shpenzimeve për fundin e vitit

SHPENZIMET		TË HYRAT	
	DM		DM
Shpenzimet për personel TV	1,948,995	Të hyra nga reklamet TV	2,506,525
Shpenzimet për personel Radio	1,270,996	Të ardhurat nga reklamet Radio	63,450
Shp. për program e prodhim TV	3,402,859	Të ardhura tjera TV	729,885
Shp. për program e prodhim R.	285,494	Të ardhura tjera Radio	344,155
Shp. fikse të mjeteve TV	594,475	Të ardhura nga donatorët TV	6,072,473
Shp. fikse të mjeteve Radio	416,523	Të ardhurat nga donatorët Radio	2,222,000
Shpenzimet tjera TV	836,697		
Shpenzimet tjera Radio	290,413		
Shpenzimet totale TV	6,783,026	Totali i të hyrave për TV	9,308,883
Shpenzimet totale Radio	2,263,426	Totali i të hyrave për Radio	2,629,605
Shpenzimet internacionale	2,492,590		
Shpenzimet totale	11,539,042	Totali i të hyrave	11,938,488
		Neto benefiti TV	314,939
		Neto benefiti Radio	84,507
		Totali i neto benefiti	399,446

Bilanci për 31 Dhjetor 2001

AKTIVI		PASIVI	
	DM		DM
Depozita dhe paratë në dorë	714,965	Llogaritë e paguara	964,738
Llogaritë e papaguara	609,153	Amortizimi i mjeteve	22,824,278
Mjetet fikse	22,864,344	Rroga e këtij viti	399,446
Totali i aktivitet	24,188,462	Totali i pasivit	24,188,462





Resurset Njerëzore


Që të bëhet një television dhe radio e mirë varet më tepër se nga asgjë tjetër nga stafi dhe ekzekutuesit të cilët janë kreativ, të angazhuar dhe të talentuar. Të ndërtuarit e një ekipi profesional dhe të aftësuar paraqet çelësin për një shërbim të suksesshëm publik transmetues. RTK-ja ka përfunduar proceset e saja rekrutuese gjatë vitit 2001. Një emrim i hapur dhe konkurrues është normë për vendet e lira të punës. Përzgjedhja korrekte drejtohet nga paneli i emërimeve apo nga stafi i lartë i kryesuar nga Drejtori i Administratës. Për të gjithë stafin janë lëshuar në fillim të vitit kontratat e punësimit dhe përshkrimi i punës. Kontratat për të pavarurit dhe artistët janë prezentuar më vonë gjatë vitit. I gjithë stafi i ri kalon nëpër periudhën provuese tremujore para se që t'iu vërtetohet posti.

Në fund të vitit 2001 kanë qenë 297 të punësuar në Televizion dhe Radio. RTK-ja do të vazhdojë të zhvillojë programin e saj gjatë vitit 2002 dhe numri i stafit parashihet të rritet për 66 deri në fund të vitit.

Numri i stafit kontrollohet shumë rigorozisht në mënyrë që të mbahet niveli i ulët i shpenzimeve. Politika e RTK-së është që të mëtohet për cilësi e jo për sasi, që të përqëndrohet në stafin e lajmeve dhe të programit dhe të minimizojë numrin e të punësuarve në departamentet përkrahëse.

Sidoqoftë, RTK-ja përkujdeset për dy ndërtesa të ndara dhe për ndërtesën e radios si dhe strehon disa kompani të tjera. Siguria është konsiderata primare posaqërisht pasi që RTK-ja ka të punësuar nga komunitetet minoritare. Për këtë, stafi i sigurimit përbën 11% të numrit të përgjithshëm të stafit të RTK-së.

28% të stafit janë femra dhe 72% meshkuj. 7% janë komunitetet pakicë - 19 anëtarë të stafit dhe tre korrespondent të radios nga rajonet serbe në Kosovë. RTK-ja duhet të luftojë që të përmirësojë këto shifra gjatë vitit 2002. Poashtu duhet të ketë një përfaqësim më të mirë të femrave në pozitat e larta të RTK-së. Për momentin, redaktori i lajmeve kryesore të orës 19.30 në television është femër siç janë edhe redaktorët e lajmeve të redaksive të lajmeve në gjuhët e pakicave në television dhe redaktori i lajmeve në gjuhën serbe në radio.



Struktura e stafit të RTK-së

RTK-ja ekziston në një ambient medial konkurrues dhe kjo poashtu nënkupton edhe një treg konkurrues të punës. RTK-ja e ka marrë parasysh këtë në nivelin e pagesave në mënyrë që të tërheqë dhe të mbajë talentët.

RTK-ja inkurajon kulturën e përmirësimit të vazhdueshëm nëpërmes investimit në trajnim. Trajnimi në vitin 2001 u përqëndrua në aftësitë e menagjimit të lartë dhe të mesëm, gazetarinë në redaksinë e lajmeve, aftësitë e prodhimit të programeve nga ekipi i të rinjve, mirëmbajtjen teknike, operacionet programore si dhe aftësitë e zërimit për operatorët teknik në radio. RTK-ja ka përdorur disa ofrues me përvojë të trajnimeve nga Europa dhe Amerika e Veriut gjatë vitit 2001, ku të gjithë prej tyre kanë punuar në RTK dhe në këtë mënyrë kanë qenë të njohur me ambientin dhe stafi ka qenë i njohtuar me ta. RTK-ja poashtu ka marrë pjesë në kurset trajnuese për gazetari të ofruar për të gjitha mediat në Kosovë nga organizatorët slq është Qendra Europiane për Gazetarinë Transmetuese.





Përgjegjësia

Si transmetues publik, RTK-ja duhet të jetë përgjegjëse për veprimtaritë e saja.

Ky raport vjetor do të jetë në dispozicion për publikun, ashtu siç kërkohet me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/13.

Rregullorja poashtu obligon RTK-në që të mbajë takime publike së paku njëherë në vit në mënyrë që të marrë komentet nga komuniteti dhe të përgjigjet në çështjet e ngritura. Takimi publik do të mbahet me 25 qershor 2002.

Plani i Biznesit i RTK-së për vitin 2002 i është dorëzuar AQF-së dhe është një kërkesë vjetore në Rregulloren e RTK-së që Bordi i Drejtorëve t'i dorëzojë buxhetin vjetor PSSP-së nëpërmes Autoritetit Qendror Fiskal.

RTK-ja është e hapur dhe e drejtpërdrejtë në kontaktet e saja me publikun. Kodi i brendshëm i Mirësjelljes thotë se stafi duhet t'i përgjigjet shpejtë dhe me mirësi pyetjeve dhe ankesave të publikut. Ankesat serioze apo ankesat nga figurat publike do të trajtohen nga niveli i lartë.

Gjatë vitit 2002, RTK-ja do të prezentojë faqen e saj të internetit për të plotësuar dy faqet e internetit të radiove të saja. Kjo faqe e internetit do t'i ofrojë publikut të dhëna të plota për RTK-në dhe do t'ia bëjë më të lehtë shikuesve e poashtu edhe joshikuesve që të kontaktojnë me RTK-në dhe të pranojnë përgjigjen.

Të shikuarit përpara në vitin 2002

Objektivi i përgjithshëm për vitet që vijnë është që të ndërtohen të arriturat e RTK-së pa sakrifikuar vlerat qendrore siç janë cilësia, objektiviteti, paanshmëria dhe llojllojshmëria në programe.

Të gjithë komunitetet duhet që të kenë mundësinë për t'u shprehur në Kosovë dhe RTK-ja do të vazhdojë që të punojë dhe ofrojë për shikuesit dhe dëgjuesit e pakicave. Do të ketë më shumë programe vendore që do të transmetohen si dhe do të përforcohen programet e tanishme.

Zbatimi i parapagimit për transmetuesin publik do të fillojë në vitin 2003 dhe RTK-ja duhet të jetë aktive në negociimin dhe në arritjen e pajtueshmërisë për funksionimin e sistemit mbledhës me KEK-un dhe agjencitë përkatëse.





Televizioni

RTK-ja do të mëtojë që të konsolidojë programin e saj të ri të prezantuar në vitin 2001 si dhe do të vazhdojë që të përmirësojë cilësinë dhe llojllojshmërinë e produksioneve të saja vendore. Përqëndrimi kryesor do të jetë në zhvillimin e programit nëpërmes një programi karakteristik dhe të cilësisë së lartë që informon, arsimon dhe inspiron.

Programi i ri i mëngjesit që do të transmetohet drejtpërdrejtë shtatë ditë në javë do të ofroj lajme, informim dhe përmbajtje. Ky program do të ofrojë për të gjithë në përzierjen e tij të lajmeve dhe të argëtimit dhe nuk do të jetë thjeshtë një edicion i zgjeruar i lajmeve.

Debati për të rinjtë i cili jipet vonë në mbrëmje ka filluar së voni me të njëjtin ekip të njëjtë të produksionit si ai i 'Amazing Be'njeri' dhe do të vazhdojë që të angazhojë të rinjtë e Kosovës në çështjet që janë me rëndësi për ta. Duke pasur popullatën më të re në Europë, vlera e një forumi ku të rinjtë diskutojnë për çështjet si abuzimi me drogë, edukimi seksual, mësimi në shkolla, muzika, punësimi dhe brengat financiare është parë si një pjesë vitale e skemës për vitin 2002.

Prodhimi për minoritetet do të rritet, me magazinën e re javore të lajmeve në gjuhën boshnjake që mendohet të fillojë në gjysmën e parë të vitit 2002. Çdonjëra nga redaksitë e lajmeve në gjuhën e minoriteteve do të zgjerohet dhe do të ofrojë një shërbim më komplet për popullatën e Kosovës që nuk e flet gjuhën shqipe në vitin 2002. Një program i ri në studio Toleranca dhe Bashkëjetesa me mysafirë nga minoritetet e ndryshme, do të fillojë të transmetohet në pranverën e vonë.

Sporti në RTK do të përmirësohet në vitin 2002 me një vërshim të takimeve të drejtpërdrejta që do të mund të shihen vetëm në RTK. RTK-ja do të jetë i vetmi kanal për tifozët e futbollit në Kosovë. RTK-ja ka të drejtat ekskluzive për Kampionatin Botëror të Futbollit 2002 nga i cili do të transmetojë drejtpërdrejt shumicën e të 64 ndeshjeve. Përveç kësaj, Premier Liga e Anglisë do të vazhdojë të transmetohet në sezonin 2002/2003. Finalja e Kupës së Italisë dhe Finalja e FA Kupës së Anglisë do të jenë në mes ndeshjeve ndërkombëtare që do të transmetohen në RTK. Basketbolli vendor, udhëheqësi i skenës sportive kosovare, dhe futbollit vendor të cilit po i ngritet reputacioni, poashtu do të prezentohen rregullisht.

Zhvillimi programor është i ndërlidhur me atë që RTK-ja të ketë stafin më së miri të trajnuar dhe

më profesional. RTK-ja do të përqëndrojë aftësitë trajnuese në vlera të gazetarisë dhe redaktimit, operacioneve për programet në studio, bërjen e programit për rekrutët e rinj si dhe trajnimin për menagjim të mesëm. Duke qenë pjesë e ekipit të RTK-së është një marrëdhënie e dyanshme dhe transmetuesi punon aq shumë për stafin sa edhe ata punojnë për të. Shërbimi satelitor digjital për diasporën do të zgjerohet duke i mbajtur qytetarët e Kosovës që jetojnë jashtë të informuar për lajmet, çështjet dhe kulturën vendore si dhe me argëtim dhe me sport.

RTK-ja është anëtare e përfshirë në Kuvendin e Përgjithshëm të Rrjetit të Transmetimit Terestrial të Kosovës (KTTN) dhe, si e tillë, RTK-ja do të jetë e angazhuar në përkrahjen për zhvillimin e KTTN-së për të përmirësuar cilësinë dhe sigurinë e rrjetit të transmetimit terestrial i cili është duke shërbyer në 80% të Kosovës.

Një nga treguesit standard të efektshmërisë është çmimi për orë. Me rritje të orëve të programit dhe me vazhdim të përqëndrimit në kursim efikas, shpenzimi për orë është përmirësuar në vitin 2001 dhe është projektuar që të vazhdojë të përmirësohet gjatë vitit 2002.

Radio

Qëllimi kryesor në vitin 2002 është që të freskohet dhe të përmirësohet cilësia e programit në të dy radiostacionet e RTK-së. Vëmendja kryesore do t'i kushtohet kombinimit të veprimeve (sinergjisë) në mes dy stacioneve, duke rritur produktivitetin dhe duke marrë burime nga jashtë përmes producentëve të pavarur në vend të punësimit të stafit të ri. Radio, si edhe televizioni, vazhdimisht do të provojë talentët e ri në transmetim. Përveç kësaj, do të ketë një rritje të prodhimit të dokumentareve dhe të përkrahjes për gazetari hulumtuese. Kjo do të ndihmohet nëpërmes programit trajnues për radion e RTK-së.

Është planifikuar një redaksi më gjithëpërfshirëse e sportit që tui siguroj tifozëve informatat më të reja sesi janë duke u treguar ekipet e tyre vendore dhe ndërkombëtare.

Teknologjia do të përqëndrohet në mënyrën sesi dëgjuesit i dëgjojnë radiostacionet e tyre. Do të zhvillohet të dëgjuarit bashkëveprues për të inkurajuar më shumë të dhëna të dëgjuesve në






programe si dhe transmetimi nëpërmes programit do të shoqërohet me sekuencë nga kamera për internet për të siguruar një lidhje të çmueshme mes prezantuesit e dëgjuesve të tij. Do të ndërmerren hulumtime të dëgjueshmërisë, posaqërisht për të identifikuar perceptcionet e dëgjuesve të RTK-së nga rradhët e minoriteteve. Produksioni muzikor do të vazhdojë me përpjekjen për promovimin e talentëve të rinj me shenjën e RTK-së.

Përfundimi

Me emërimin e Drejtorit të ri të Përgjithshëm në vitin 2002, RTK-ja ka evoluuar nga një operacion emergjent i udhëhequr nga ndërkombëtarët në një transmetues të vërtetë kosovar që ka vendosur rrënjë të fuqishme dhe që ka fituar lojalitet dhe dashuri nga shikuesit/dëgjuesit. Viti 2002 do të jetë një vit testues për Kosovën dhe RTK-në. Identiteti i Kosovës duhet të pasqyrohet përmes shërbimit të saj publik transmetues të pavarur. RTK-ja do të përpiqet që të ushtrojë plotësisht përgjegjësinë e saj për t'iu shërbyer të gjitha komuniteteve të Kosovës me anë të programit cilësor si në televizion poashtu edhe në radio.



Informatat kryesore

Rrjeti televiziv terestrial dhe frekuencat satelitore

Terrestrial: Pristina: channel 37UHF , Zatriq: channel 9VHF , Maja e Gjelbert: channel 12VHF, Crnusha: channel 7VHF

Digital satellite: Eutelsat W2 16 degrees East, Frequency: 12633, Polarity: Vertical, FEC: ½, Sybl Rate: 4.883

Frekuencat e Radios

Radio Kosova: Modulimet e frekuencës: Prishtinë: 91.9, Golesh: 95.7, Zatriq: 88.9, Maja e Gjelbërt: 88.5 Në valë të mesme: 549KHz (në tërë Kosovën) dhe 1377KHz (Prizren)

Radio Blue Sky: Modulimet e frekuencës: Prishtinë: 93.3, Golesh: 97.7, Zatriq: 92.4, Maja e Gjelbërt: 90.5



Faqet e internetit

RTK Television: www.rtklive.com

Radio Kosova: www.radio-kosova.com

Blue Sky: www.blueskylive.com

Numrat e telefonit dhe faksit

TV: Telefon: 00 381 (0) 38 231 211 or 00 381 (0) 38 232073, Fax: 00 381 (0) 38 235 336

Radio: Telefon: 00 381 (0) 38 242 205 or 00 381 (0) 38 240 565, Fax: 00 381 (0) 38 249 074

